



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 209 dt.20.10.1994

Këshilli Bashkiak i Qytetit Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e Seksionit të Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore “Për dhënie fondi për pagat e disa ndërmarrjeve që janë në konservim dhe likuidim”

VENDOSI

1. Për Ndërmarrjen e Therjes së Shpendëve, miratimin e një fondi page mujore prej 61.000 lekë me këtë administratë:

- drejtori
- financier
- mekanik për mirëmbajtje
- tre roje

Efektet financiare fillojnë më dt.01.09.1994

2. Për ndërmarrjet e Prodhimit Avullit (ish Kombinati i Mishit) miratimin e një fondi page mujore prej 50.000 lekë me këtë administratë :

- k/degës ekonomike
- përgjegjës punësim page
- katër roje

Efektet financiare fillojnë më dt.01.09.1994.

3. Për Ndërmarrjen Tregtare Fruta Perime Nr.3, një fond page mujore prej 25.000 lekë me këtë administratë :

- likuidatorë
- financiere

Efektet financiare fillojnë më dt.15.06.1994.

4. Për Ndërmarrjen e Transportit Industrisë Ushqimore, një fond page mujore prej 26.832 lekë me këtë administratë :

- drejtor
- financier
- magazinjer 2+4 roja

Efektet financiare fillojnë më dt.01.07.1994

5. Ndërmarrja Tregtare me shumicë Nr.7, me një fond page prej 21.000 lekë me këtë administratë :

- Likuidatore 1
- Mercologe 1
- Financiere 1
- Magazinier 1

Efektet financiare fillojnë më dt.15.08.1994.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit Financiar, ndërsa për ndjekjen e tij Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore.

KRYETARI

BESNIK PETRELA